PSH.nr.710/20
717/20
724/20
727/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatorët ekonomik: OE "Selmans Network" Shpk-Prishtinë, OE "Schafberger Jr"Gmbh-Gllogoc, grupi i OE NSH "Clean";"Rexha"Shpk"-Ferizaj dhe OE "Efa Dienstlestung"Gmbh-Prishtinë, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull: "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të Universitetit të Prishtinës -"Hasan Prishtina" me nr.të prokurimit: 242-19-5702-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Universiteti i Prishtinës", më datën: 12.11.2020, mori këtë:

U R DH Ë R E S Ë

I.<u>APROVOHEN</u>, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik: OE "Selmans Network" Shpk-Prishtinë, OE "Schafberger Jr"Gmbh-Gllogoc, grupi i OE NSH "Clean"; "Rexha"Shpk"-Ferizaj dhe OE "Efa Dienstlestung"Gmbh-Prishtinë, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull: "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të Universitetit të Prishtinës -"Hasan Prishtina" me nr.të prokurimit: 242-19-5702-2-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Universiteti i Prishtinës".

<u>II.OBLIGOHET,</u> autoriteti kontraktues- Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" që ta zbatojë në përpikëri vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së Psh. Nr. 368-374-384/20 të datës 15.07.2020, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të Universitetit të Prishtinës -"Hasan Prishtina" me nr.të prokurimit: 242-19-5702-2-1-1

IV. <u>URDHËROHET</u>, Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", që në afat prej 5 (pesë) ditësh kalendarike të njoftoj OSHP-në dhe operatorin ekonomik, lidhur me zbatimin e vendimit të OSHP-së me numër Psh. nr. 368-374-384/20 të datës 15.07.2020, përkitazi me aktivitetin e prokurimit me

titull: "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të Universitetit të Prishtinës - "Hasan Prishtina" me nr.të prokurimit: 242-19-5702-2-1-1.

IV. Mos respektimi i kësaj urdhërese, brenda periudhës prej 5 ditë kalendarike, do ta detyroj Panelin Shqyrtues që të veproj konform nenit 131 të LPP-së, dhe njëkohësisht të kërkoj nga KRPP-ja, anulimin e licencës për menaxherin e prokurimit të Autoriteti Kontraktues (AK) – Universiteti i Prishtinës, konform nenit 25 paragrafi 8 dhe 9 të LPP-së.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik OE "Selmans Network" Shpk-Prishtinë, OE "Schafberger Jr"Gmbh-Gllogoc, grupi i OE NSH "Clean"; "Rexha"Shpk"-Ferizaj dhe OE "Efa Dienstlestung"Gmbh-Prishtinë, i aprovohen si pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: OE "Selmans Network" Shpk-Prishtinë, OE "Schafberger Jr"Gmbh-Gllogoc, grupi i OE NSH "Clean"; "Rexha"Shpk"-Ferizaj dhe OE "Efa Dienstlestung"Gmbh-Prishtinë, si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 25.09.2020, me 22.09.2020 , me datë 26.09.2020 , dhe me datë 27.09.2020, me nr. 710-717-724-727/20, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull: "Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave të jashtme dhe të brendshme të Universitetit të Prishtinës -"Hasan Prishtina" me nr.të prokurimit: 242-19-5702-2-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"Universiteti i Prishtinës", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues për OE "Selmans Network" Shpk-Prishtinë ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 ,28 ,56,62 dhe 72 të LPP-së,
- Autoriteti kontraktues për OE "Schafberger Jr"Gmbh-Gllogoc, ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 7 , 54,59 ,62, 69 dhe 70 të LPP-së,
- Autoriteti kontraktues për grupin e OE NSH "Clean"; "Rexha"Shpk"-Ferizaj ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7 ,59 dhe 60 të LPP-së ,

- Autoriteti kontraktues për OE "Efa Dienstlestung"Gmbh-Prishtinë, ka vepruar në kundërshtim me nenin:7 ,27 ,59 60 dhe 72 të LPP-së .

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 12.10.2020, lidhur me pretendimet ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje ne pretendimet e OE ankues "Selmans Network" Sh.p.k-Prishtinë

Përgjigje në Pretendimi nr.1, Lidhur me pretendimin OE "Selmans Network"Shpk se AK gjatë fazës së rivlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit,konkretisht kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € duke dëshmuar me një liste të kontratave, kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave dhe sipas OE ankues përkundër asaj që ka dorëzuar listën e kontratave dhe referencave që tejkalojnë vlerën e kërkuar nga AK oferta e tyre është shpallur e papërgjegjshme,eksperti shyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe në vendimin PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020,citoj vendimin e OSHP-së lidhur me këtë pretendim "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se OE "Selmans Network"Shpk ka dorëzuar një listë të kontratave të realizuara dhe një listë të kontratave në realizim. Në kuadër te listës së kontratave të realizuara ka prezantuar dy referenca mbi realizimin e kontratave por që nuk përmbushin shumën e kërkuar prej 2,500,000.00 € sipas kërkesës së DT.

Referenca e parë e lëshuar nga UP'Hasan Prishtina" në vlerë prej 1,733,206.78 për kontratën e përfunduar me datë 31.03.2017 është konform dosjes së tenderit.

Referenca e dytë e lëshuar nga KK Gjakove për kontratën me numër identifikues 632-16-013-211 e lidhur me datë 01.06.2018 me afat deri me 31.05.2020 në vlerë prej 118,862.88 € nuk dëshmon plotësisht realizimin e kontratës sepse kjo kontratë akoma është në implementim deri me datë 31.05.2020.

Lista e kontratave tjera të prezantuara si kontrata në realizim nuk përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar kontrata të realizuara(përfunduara) në tri vitet e fundit,andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lista e kontratave të OE ankues të prezantuar në ankesën e tyre si dhe sqarimet dhe dëshmitë e dorëzuara në fazën e rivlerësimit nuk e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit .Për kontratën e lidhur me Komunën e

Pejës me datë 18.02.2015 për "Pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të SHKÇK-së" sipas çmimit të shërbimeve mujore prej mujor 33,120.00 €,OE ankues nuk ka ofruar referencë për realizimin e shërbimeve. Dëshmia e dorëzuar nga OE ankues lidhur me këtë kontratë e cila mban datën 27.03.2020 që është një e-mail nga komuna e Pejës me të cilën vetëm konfirmohet se ka pasur një kontratë të nënshkruar në mes të Komunës së Pejës dhe OE"Selmans Network" por mungon referenca e realizimeve të shërbimeve dhe për ekspertin shqyrtues kjo dëshmi/e-mail nuk përmbush kërkesën e dosjes së tenderit.
Dy referencat tjera të lëshuara nga Universiteti i Gjakovës në vlerë prej 133,232.08 € dhe Universiteti i Pejës në vlerë prej 92,241.08 €,njëra pa datë të lëshimit dhe tjetra me datë të lëshimit 30.03.2020 nuk arrijnë të përmbushin vlerën e kërkuar prej 2,500,000.00 € për kontrata të realizuara në tri vitet e fundit.
Paneli shqyrtues sqaron se kërkesa e dosjes së tenderit ka qene shumë e qartë që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se OE ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € duke dëshmuar me një liste të kontratave,kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave dhe pretendimi i OE ankues se nuk ka mundur ti siguroj dëshmite e nevojshme për shkak të emergjencës shëndetësore (pandemia Covid 19) për ekspertin shqyrtues është i pa qëndrueshëm sepse këto dëshmi(kontrata,referenca) OE është dashur ti kompletoj në rastin e dorëzimit të ofertës në e-prokurim,andaj duke pasur parasysh sqarimet e dhëna si më lartë,paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar" Pretendimi ankimor është i pabazuar.

Sa i përket pretendimeve të OE "Selmans Network"Shpk ndaj OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit,eksperti shqyrtues sqaron se te gjitha këto pretendime janë trajtuar në vendimet e OSHP-së, PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020 dhe disa nga këta OE janë palë pa interes juridik dhe material.
Pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Përgjigje ne pretendimet e OE ankues "Schafberger Jr"Gmbh-Gllogoc

Përgjigje në Pretendimi nr.1, Lidhur me pretendimin e OE ankues "Schafberger Jr "Gmbh, se AK gjatë rivlerësimit të tenderëve përsëri ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin e njëjtë se nuk përmbush kërkesën e 7. të dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet të jetë i certifikuar me SA 8000 Smeta sadex dhe BSCI – Përgjegjshmëria Sociale dhe Etika,që sipas OE ankues ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSH-së,PSH.nr. 368-374-384/20 të datës 15.07.2020,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në dy vendimet e OSHP-së PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe në vendimin e fundit të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit, PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020,citoj një pjesë të vendimit të fundit "Paneli Shqyrtues sqaron se

ky pretendim i OE pjesërisht është trajtuar edhe në vendimin e OSHP-së,PSH.nr. 800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019. Konform vendimit të OSHP-së,AK ka kërkuar sqarime/dokumente shtesë për çertifikatat Smeta Sadex dhe BSCI të cilat janë dërguar nga ana e OE" Schafberger Jr "Gmbh" me datë 17.01.2020.
Edhe në ankesën e tyre OE sqaron se në momentin e hapjes së ofertave ka qenë në procedurë të auditimit nga një kompani e huaj për raportin Smeta Sadex dhe BSCI dhe për t'u çertifikuar për këtë standard duhet një auditim kompleks që zgjat për një periudhë disa mujore,andaj nga sqarimet e lartëcekura Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit profesional sqaron se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar për shkak se OE ankues ka qene në proces auditimi/çertifikimi për këtë standard,ndërsa në momentin e dorëzimit të tenderit nuk ka qenë i licencuar/çertifikuar me këtë standard të ri siç është kërkuar në dosjen e tenderit.
Pretendimi ankimor është i bazuar

Sa i përket pretendimeve tjera të OE ankues "Schafberger Jr "Gmbh ndaj OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit,eksperti shqyrtues sqaron se këto pretendime janë trajtuar në dy vendimet e Panelit Shqyrtues,PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe në vendimin e fundit të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit, PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020.

Përgjigje në pretendimet e grupit të OE NSH "Clean"; "Rexha"Shpk"-Ferizaj
Përgjigje në Pretendimi nr.1, Lidhur me pretendimin e grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk",se AK gjatë rivlerësimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit,konkretisht kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 €,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019, citoj një pjesë të vendimit të Panelit Shqyrtues "Lidhur me pretendimin e OE ankues "Schafberger Jr"Gmbh,se AK gjatë fazës së vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk edhe pse oferta e tyre nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe si e tille duhet të shpallej e papërgjegjshme.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se në Dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se AK ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € duke dëshmuar me një liste të kontratave,kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave. Grupi i OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk ka ofruar kontrata të realizuara për secilin anëtare të grupit duke i prezantuar disa tabela për kontratat e realizuara.
Në tabelën e pare të ofruar për OE"Clean" janë prezantuar tri referenca:

Referenca e parë për kontratën e realizuar për Pastrimin dhe mirëmbajtjen higjienike te objekteve të Komunës së Ferizajt në vlerë prej 209,398.00 € e përmbush kërkesën e DT.Kontrata ka filluar me date 16.03.2015 me afat 24 muaj. Gjithashtu edhe referenca për kontratën me Ministrinë e Punëve të Brendshme për 'Shërbimet e pastrimit të objekteve të MPB-së" e lidhur me datë 25.07.206 me afat deri 31.07.2017 përmbush kërkesën e DT, por në këtë reference nuk ka çmim total dhe nuk dihet sa ka qene shuma e kontratës së realizuar.

Ndërsa referenca e tretë e prezantuar në listën e kontratave dhe referencave për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objektit të Qendrës së Shërbimit Emergjent Primar- Ferizaj në vlerë prej 38,400.00,në dokumentacionin e ofertës së dorëzuar nuk ka reference të prezantuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit sqaron se lista e ofruar nga OE "Rexha"(anëtar i grupit ekonomik) nga përshkrimi i projekteve rezulton se këto kontrata janë kontrata për punë. Të gjitha kontratat edhe referencat e bashkangjitura kane të bëjnë me ndërtimin e shkollave,ndërtimin e ambulancës,ndërtimin e shtëpive dhe këto nuk mund të konsiderohen kontrata për shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm. Andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se oferta e grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk edhe nga vendimi i AK dhe vendimi i Panelit Shqyrtues është shpallur e papërgjegjshme.

Tenderi i grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk në vendimin e AK-së të datës 27.05.2020 është shpallur tender i papërgjegjshëm dhe ky grup i OE nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim apo ankesë ne OSHP,andaj grupi i OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk konform nenit 4.1.26 të LPP-së duhet të trajtohet si palë pa interes material dhe juridik.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje ne pretendimet e OE ankues "Efa Dienstlestung"Gmbh-Prishtinë

Përgjigje në pretendimin, Lidhur me pretendimin e OE "Efa Dienstleistung"Gmbh se AK gjatë fazës së rivlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve përsëri e ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se lista e kontratave me referenca në tri vitet e fundit nuk është sipas kritereve të kërkuara,që sipas OE ankues ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.368-374-384/20,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së,PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020,citoj një pjesë të vendimit,"Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues profesional konstaton se OE "Efa Dienstleistung" Gmbh në ofertën e dorëzuar ka prezentuar një listë të kontratave dhe disa referenca për realizimin e shërbimeve në lëmin e pastrimit.Referenca nga Zyra e

Infrastrukurës/Landi i Shtugartit e cila është e përkthyer edhe në gjuhën shqipe e cila për vitet 2016,2017 dhe 2018 është mbi 4 milion euro dhe plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Nga AK nuk është sqaruar në asnjërin nga vendimet e tyre arsyeja se përse këto referenca nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit,andaj paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar".

AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj informacione shtesë nga OE ankues lidhur me dokumentet e prezantuara lidhur me kontratat dhe referencat e realizuara.

Pretendimi ankimor është i bazuar

Eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka bërë rivlerësimin,ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe rekomandimeve të vendimeve të OSHP-së,PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020, por ka përsëritur vlerësimin paraprak duke anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së,andaj eksperti shqyrtues rekomandon që aktiviteti të kthehet në **ri-vlerësim.**

Gjatë procesit të rivlerësimit AK duhet të fokusohet më shumë në analizat financiare të OE se a janë konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe posaçërisht a i mbulojnë ofertat financiare kërkesat e ligjit të punës siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE ankues të aprovohen pjesërisht si të bazuara,të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 12.10.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues, nuk e ka njoftuar OSHP-në, se a pajtohet apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, OE "Selmans Network" Shpk-Prishtinë, me datë: 15.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Sqarime shtese:

Pasi kemi pranuar mendimin e ekspertit me keqardhje ju njoftojme se ne si OE, NUK PAJTOHEMI fare me mendimin e Ekespertit duke kerkuar në të njejtën kohe që të mbahet seancë nga Paneli i OSHP-së, në mënyrë që ne si OE ti mbrojmë qendrimet tona.

ARSYETIM

Eksperti i OSHP-së, në ekspertizën e tij (jo vetem ne këtë ekspertizë) nuk është lëshuar fare në pretendimet tona ankimore po vetem ka bërë përshkrim të vendimit të më hershëm të OSHP-së e ku as në atë vendim nuk janë trajtuar fare pretendimet tona ankimore. Eksperti jo vetem që nuk ka analizuar pretendimet tona ankimore por as provat shkresore të prezantuara së bashku me Ankesën e bërë në OSHP, por që as në nuk e dim se si thirret në disa shkresa që as nuk janë objekt i trajtimit të ankesës tonë kurse pretendimin tonë që ne kemi dhe plotësojmë kriterin për kërkesat dhe mundësitë teknike dhe profesinonale në qarkullim prej 2,500,000 duke prezentuar kontratat dhe referencat që tejkalojnë këtë vlerë nuk i ka trajtuar në asnjë rast duke u munduar ti anashkaloj ato, pavarësisht që si prova shkresore kanë qenë të bashkangjitura edhe në ankesën në OSHP. Prandaj, duke qenë se Eksperti nuk është lëshuar fare për të analizuar pretendimet tona pjesmarrja në seancën e Panelit të OSHP-së është bërë e domosdoshme.

Operatori Ekonomik, OE "Schafberger Jr"Gmbh-Gllogoc, me datë: 14.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, grupi i OE NSH "Clean"; "Rexha"Shpk"-Ferizaj, me datë: 14.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, OE "Efa Dienstlestung"Gmbh-Prishtinë, me datë: 15.10.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Sqarime shtese:

Të nderuar,

Deklarojm se pajtohemi pjesërisht me mendimin e ekspertit përvec mendimit ku cekë që:

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në dy vendimet e OSHP-së PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe në vendimin e fundit të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit, PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020,citoj një pjesë të vendimit të fundit "Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE pjesërisht është trajtuar edhe në vendimin e OSHP-së,PSH.nr. 800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019. Konform vendimit të OSHP-së,AK ka kërkuar sqarime/dokumente shtesë për çertifikatat Smeta Sadex dhe BSCI të cilat janë dërguar nga ana e OE" Schafberger Jr "Gmbh" me datë 17.01.2020.
Edhe në ankesën e tyre OE sqaron se në momentin e hapjes së ofertave ka qenë në procedurë të auditimit nga një kompani e huaj për raportin Smeta Sadex dhe BSCI dhe për t'u çertifikuar për këtë standard duhet një auditim kompleks që zgjat për një periudhë disa mujore,andaj nga sqarimet e lartëcekura Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit profesional sqaron se pretendimi ankimor është pjesrësisht i bazuar për shkak se OE ankues ka qene në proces auditimi/çertifikimi për këtë standard,ndërsa në momentin e dorëzimit të tenderit nuk ka qenë i licencuar/çertifikuar me këtë standard të ri siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Pretendimi ankimor është i bazuar

Nuk pajtohemi me këtë mendim të ekspertit pasi që ka qenë kërkesë decidive që të dorëzohen certifikatat e noterizuara, dhe se sa i përket arsyetimit se ka qenë në fazë të auditimit OE ka pasur rastin para hapjes së ofertave të ushtroj kërkesë për ri-shqyrtim dhe ankesë në OSHP, por në momentin e dorëzimit të ofertave nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi se është në procedurë. Si dhe vetë OE e pranon se ka dërguar një dokument i cili përmban datë pas hapjes së ofertave. Dhe sipas LPP-së

Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë pika

3.Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Pra duke u bazuar në LPP nuk është e mundur që të pranohet si pretendim i bazuar përderisa vetë OE pranon se nuk e posedon certifikatë dhe ka dorëzuar dokument me datë të lëshimit pas hapjes së ofertave në kundërshtim me nenin 72 pika 3 dhe si i tillë nuk mundë të pranohet si çështje e bazuar dhe si ofertë që të krijohet mundësia për të qenë e përgjegjshme. Andaj ne nuk pajtohemi me këtë pikë në ekspertizë dhe kërkojmë zbatim të tërësishëm dhe të drejtë të të gjitha pretendimeve sipas dispozitave ligjore.
Pasi që e njëjta çështje është duke u ri-vlerësuar, shqyrtuar që tash më një vit, panel i nderuar ju lutemi të shtjelloni të gjitha elementet e ankesave, vendimeve, në kronologji dhe të vendosni vendim meritor të ligjshëm.
Me respekt,

Administrata EFA

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Paneli shqyrtues shqyrtoj dhe analizoj pretendimet e OE ankues "Selmans Network" Sh.p.k - Prishtinë

Lidhur me pretendimin OE "Selmans Network" Shpk se AK gjatë fazës së rivlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit, konkretisht kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se ka kryer me sukses shërbime në lëminë e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € duke dëshmuar me një liste të kontratave, kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave dhe sipas OE ankues përkundër asaj që ka dorëzuar listën e kontratave dhe referencave që tejkalojnë vlerën e kërkuar nga AK oferta e tyre është shpallur e papërgjegjshme, paneli shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues është trajtuar në vendimin e OSHP-së PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe në vendimin PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020: "Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional sqaron se OE "Selmans Network"Shpk ka dorëzuar një listë të kontratave të realizuara dhe një listë të kontratave në realizim. Në kuadër te listës së kontratave të realizuara ka prezantuar dy referenca mbi realizimin e kontratave por që nuk përmbushin shumën e kërkuar prej 2,500,000.00 € sipas kërkesës së DT. Referenca e parë e lëshuar nga UP'Hasan Prishtina" në vlerë prej 1,733,206.78 për kontratën e përfunduar me datë 31.03.2017 është konform dosjes së tenderit. Referenca e dytë e lëshuar nga KK Gjakove për kontratën me numër identifikues 632-16-013-211 e lidhur me datë 01.06.2018 me afat deri me 31.05.2020 në vlerë prej 118,862.88 € nuk dëshmon plotësisht realizimin e kontratës sepse kjo kontratë akoma është në implementim deri me datë 31.05.2020. Lista e kontratave tjera të prezantuara si kontrata në

realizim nuk përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit ku është kërkuar kontrata të realizuara (përfunduara) në tri vitet e fundit,andaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Lista e kontratave të OE ankues të prezantuar në ankesën e tyre si dhe sqarimet dhe dëshmitë e dorëzuara në fazën e rivlerësimit nuk e përmbushin kërkesën e dosjes së tenderit. Për kontratën e lidhur me Komunën e Pejës me datë 18.02.2015 për "Pastrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve të SHKÇK-së" sipas çmimit të shërbimeve mujore prej mujor 33,120.00 €,OE ankues nuk ka ofruar referencë për realizimin e shërbimeve. Dëshmia e dorëzuar nga OE ankues lidhur me këtë kontratë e cila mban datën 27.03.2020 që është një e-mail nga komuna e Pejës me të cilën vetëm konfirmohet se ka pasur një kontratë të nënshkruar në mes të Komunës së Pejës dhe OE"Selmans Network" por mungon referenca e realizimeve të shërbimeve andaj kjo dëshmi/e-mail nuk përmbush kërkesën e dosjes së tenderit.

Dy referencat tjera të lëshuara nga Universiteti i Gjakovës në vlerë prej 133,232.08 € dhe Universiteti i Pejës në vlerë prej 92,241.08 €, njëra pa datë të lëshimit dhe tjetra me datë të lëshimit 30.03.2020 nuk arrijnë të përmbushin vlerën e kërkuar prej 2,500,000.00 € për kontrata të realizuara në tri vitet e fundit. Paneli shqyrtues sqaron se kërkesa e dosjes së tenderit ka qene shumë e qartë që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se OE ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € duke dëshmuar me një liste të kontratave, kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave dhe pretendimi i OE ankues se nuk ka mundur ti siguroj dëshmite e nevojshme për shkak të emergjencës shëndetësore (pandemia Covid 19) për ekspertin shqyrtues është i pa qëndrueshëm sepse këto dëshmi (kontrata, referenca) OE është dashur ti kompletoj në rastin e dorëzimit të ofertës në e-prokurim,andaj duke pasur parasysh sqarimet e dhëna si më lartë, paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar"

Paneli shqyrtues sqaron se kjo pikë është sqaruar në vendimet e OSHP-së ndërsa sa i përket pretendimeve të OE "Selmans Network"Shpk ndaj OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, paneli shqyrtues poashtu sqaron se te gjitha këto pretendime janë trajtuar në vendimet e OSHP-së, PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020 dhe disa nga këta OE janë palë pa interes juridik dhe material.

Paneli shqyrtues po ashtu shqyrtoj pretendimet e OE ankues "Schafberger Jr" Gmbh - Gllogoc

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Schafberger Jr "Gmbh, se AK gjatë rivlerësimit të tenderëve përsëri ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin e njëjtë se nuk përmbush kërkesën e 7. të dosjes së tenderit ku është kërkuar që OE duhet të jetë i certifikuar me SA 8000 Smeta sadex dhe BSCI – Përgjegjshmëria Sociale dhe Etika, paneli shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në dy vendimet e OSHP-së PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe në vendimin e fundit të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit, PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020, citat: "Paneli Shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE pjesërisht

është trajtuar edhe në vendimin e OSHP-së, PSH.nr. 800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019. Konform vendimit të OSHP-së, AK ka kërkuar sqarime/dokumente shtesë për certifikatat Smeta Sadex dhe BSCI të cilat janë dërguar nga ana e OE" Schafberger Jr "Gmbh" me datë 17.01.2020.

Edhe në ankesën e tyre OE sqaron se në momentin e hapjes së ofertave ka qenë në procedurë të auditimit nga një kompani e huaj për raportin Smeta Sadex dhe BSCI dhe për t'u certifikuar për këtë standard duhet një auditim kompleks që zgjat për një periudhë disa mujore, andaj nga sqarimet e lartcekura Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit profesional sqaron se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar për shkak se OE ankues ka qene në proces auditimi/certifikimi për këtë standard, ndërsa në momentin e dorëzimit të tenderit nuk ka qenë i licencuar/certifikuar me këtë standard të ri siç është kërkuar në dosjen e tenderit, por pasi qe Operatori Ekonomik veq ka filluar me herët certifikimin me këtë standard AK mund ta konsideroj si devijim te vogël konform nenit 59 te LPP-se.

Sa i përket pretendimeve tjera të OE ankues "Schafberger Jr "Gmbh ndaj OE tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, paneli shqyrtues sqaron se këto pretendime janë trajtuar në dy vendimet e Panelit Shqyrtues, PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe në vendimin e fundit të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit, PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020.

Paneli shqyrtues shqyrtoj pretendimet e grupit të OE NSH "Clean"; "Rexha"Shpk"-Ferizaj

Lidhur me pretendimin e grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk",se AK gjatë rivlerësimit të tenderëve ka eliminuar ofertën e tyre me arsyetimin se nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit, konkretisht kërkesën 1 të kapacitetit teknik dhe profesional që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 €, paneli shqyrtues sqaron se edhe pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019: "Lidhur me pretendimin e OE ankues "Schafberger Jr"Gmbh,se AK gjatë fazës së vlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve ka rekomanduar për kontratë ofertën e grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk edhe pse oferta e tyre nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe si e tille duhet të shpallej e papërgjegjshme. Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit ka sqaruar se në Dosjen e tenderit është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme se AK ka kryer me sukses shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm në tri vitet e fundit jo me pak se 2,500,000.00 € duke dëshmuar me një liste të kontratave, kontrata dhe referenca për realizimin e kontratave. Grupi i OE NSH "Clean";"Rexha"Shpk ka ofruar kontrata të realizuara për secilin anëtare të grupit duke i prezantuar disa tabela për kontratat e realizuara.

Në tabelën e pare të ofruar për OE"Clean" janë prezantuar tri referenca: Referenca e parë për kontratën e realizuar për Pastrimin dhe mirëmbajtjen higjienike te objekteve të Komunës së Ferizajt në vlerë prej 209,398.00 € e përmbush kërkesën e DT. Kontrata ka filluar me date 16.03.2015 me afat 24 muaj. Gjithashtu

edhe referenca për kontratën me Ministrinë e Punëve të Brendshme për 'Shërbimet e pastrimit të objekteve të MPB-së" e lidhur me datë 25.07.206 me afat deri 31.07.2017 përmbush kërkesën e DT, por në këtë reference nuk ka çmim total dhe nuk dihet sa ka qene shuma e kontratës së realizuar.

Ndërsa referenca e tretë e prezantuar në listën e kontratave dhe referencave për pastrimin dhe mirëmbajtjen e objektit të Qendrës së Shërbimit Emergjent Primar- Ferizaj në vlerë prej 38,400.00, në dokumentacionin e ofertës së dorëzuar nuk ka reference të prezantuar.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit profesional të prokurimit ka sqaruar se lista e ofruar nga OE "Rexha"(anëtar i grupit ekonomik) nga përshkrimi i projekteve rezulton se këto kontrata janë kontrata për punë. Të gjitha kontratat edhe referencat e bashkangjitura kane të bëjnë me ndërtimin e shkollave, ndërtimin e ambulancës, ndërtimin e shtëpive dhe këto nuk mund të konsiderohen kontrata për shërbime në lëmin e pastrimit të brendshëm.

Ashtu sic është sqaruar në vendimet e cekura si më lartë, paneli shqyrtues sqaron se oferta e grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk edhe nga vendimi i AK dhe vendimi i Panelit Shqyrtues është shpallur e papërgjegjshme.

Tenderi i grupit të OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk në vendimin e AK-së të datës 27.05.2020 është shpallur tender i papërgjegjshëm dhe ky grup i OE nuk ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim apo ankesë ne OSHP, andaj grupi i OE NSH"Clean";"Rexha"Shpk konform nenit 4.1.26 të LPP-së në këtë aktivitet të prokurimit vlerësohet si palë pa interes material dhe juridik.

Paneli shqyrtues shqyrtoj dhe analizoj pretendimet ankimore të OE ankues "Efa Dienstlestung" Gmbh - Prishtinë

Lidhur me pretendimin e OE "Efa Dienstleistung"Gmbh se AK gjatë fazës së rivlerësimit,ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve përsëri e ka shpallur të papërgjegjshme ofertën e tyre me arsyetimin se lista e kontratave me referenca në tri vitet e fundit nuk është sipas kritereve të kërkuara, paneli shqyrtues sqaron se ky pretendim është trajtuar në vendimin e OSHP-së, PSH.nr.368-374-384/20 të datës 15.07.2020, citat një pjesë të vendimit: "Paneli Shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues profesional konstaton se OE "Efa Dienstleistung" Gmbh në ofertën e dorëzuar ka prezentuar një listë të kontratave dhe disa referenca për realizimin e shërbimeve në lëmin e pastrimit. Referenca nga Zyra e Infrastrukurës/Landi i Shtugartit e cila është e përkthyer edhe në gjuhën shqipe e cila për vitet 2016,2017 dhe 2018 është mbi 4 milion euro dhe plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Nga AK nuk është sqaruar në asnjërin nga vendimet e tyre arsyeja se përse këto referenca nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit, andaj paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i bazuar". Paneli shqyrtues shqyrton se AK konform nenit 72 të LPP-së ka mundur të kërkoj informacione shtesë nga OE ankues lidhur me dokumentet e prezantuara lidhur me kontratat dhe referencat e realizuara.

Paneli shqyrtues konstaton se AK nuk ka bërë rivlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe rekomandimeve të vendimeve të OSHP-së PSH.nr. 800-805-812-821/19 të datës 17.12.2019 dhe PSH.nr. 368-374-384/20 të datës 15.07.2020, por ka përsëritur vlerësimin paraprak duke anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që ta zbatoj në tërësi vendimet e lartcekura, dhe poashtu të respektohet neni 56 dhe 59 i LPP-së. Paneli Shqyrtues njofton Autoritetin Kontraktues që të ndërmerr masa për zbatimin e vendimit të sapo përmendur brenda pesë (5) ditëve, në të kundërtën Paneli Shqyrtues detyrohet që të shqiptoj masa kundër Autoritetit Kontraktues në kuptim të nenit 105 dhe 131 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të kësaj urdherese.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Universiteti i Prishtinës -"Hasan Prishtina"
1x1 OE-ve: OE "Selmans Network" Shpk-Prishtinë,
1x1 OE"Schafberger Jr"Gmbh-Gllogoc,
1x1 OE NSH "Clean"; "Rexha"Shpk"-Ferizaj
1x1 OE "Efa Dienstlestung"Gmbh-Prishtinë
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.